

Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”

Vlerësimi i impaktit socio - ekonomik

Në Shqipëri janë rreth 10,000 km rrugë rurale që administrohen nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të nivelit të parë e të dytë.

Një studim i Bankës Botërore i vitit 2006 konstatonte se mbi 70 % e rrugëve ishin në gjendje të keqe apo shumë të keqe. Ky klasifikim shoqërohej me shënimin se një pjesë e mirë e rrugëve ishin në një gjendje të tillë sa ishin klasifikuar në gjendje “shumë të keqe”, por që vështirë se mund të klasifikoheshin si rrugë sepse ishin të pakalueshme në një pjesë të madhe të vitit.

Deri në vitin 2008 investimet për rrugët dytësore dhe lokale thuajse mungonin, ishin të copëzuara, pa koordinim mes investitorëve, zbatuesve dhe përfituesve dhe mbi të gjitha me standarde tërësisht të tejkaluara në raport me kërkesën e rritur për transport.

Duke qenë se pothuajse gjysma e popullsisë së vendit jeton në zonat rurale është e qartë pasoja që rrjeti rrugor dytësor kishte në ritmet e zhvillimit ekonomik, treguesit e shërbimeve sociale si shëndetësia e arsimit apo ndjesinë shumë të prekshme psikologjike të izolimit e braktisjes.

Në kushtet e një situatë komplekse që kërkonte koordinimin e strategjive kombëtare dhe strategjive të donatorëve për të harmonizuar investimet në shkallë kombëtare, Fondi Shqiptar i Zhvillimit konceptoi Programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale”.

Ky angazhim i FSHZH erdhi në vijim të angazhimeve të hershme të institucionit në zbatimin e disa projekteve me rëndësi në zhvillimin social - ekonomik të vendit në nivel rajonal dhe lokal.

Programi filloi jetën e tij në vitin 2008 duke pasur si objektiv tri shtylla kryesore:

- Ngritjen e një sistemi funksional të inventarizimit të rrjetit rrugor dhe prioritizimin e investimeve;
- Rehabilitimin në shkallë të gjerë të rrjetit rrugor dytësor dhe lokal, ku u përfshinë 144 segmente rrugore dhe ura në një total prej 1,200 km;
- Stabilizimin e proceseve të funksionimit dhe mirëmbajtjes së këtij rrjeti rrugor;

Ngritja e infrastrukturës së projektit që u mbështet fillimisht nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare, krijoi terrenin për afrimin dhe bashkëpunimin e donatorëve të tjerë si OFID, CEB, BEI, BERZH, BE (IPA 2008-2011, WBIF), IDB, KfW, duke e shndërruar Programin e Rrugëve Dytësore në një nga Programet më me peshë, në Shqipëri.

Programi arriti të sigurojë një financim prej 368 milionë USD për rehabilitimin e 1,200 km rrugë dytësore dhe lokale.

Në funksion të nxitjes së zhvillimit rajonal dhe lokal, ndërhyrja e FSHZH është mbështetur në disa prioritete:

- *Nxitja e zhvillimit ekonomik në zona me dendësi të madhe të popullsisë dhe prodhimtari të lartë bujqësore dhe blegtorale.* Këtu mund të përmendim rrugët në zonat rurale të Tiranës, zonën e Myzeqesë (Fier, Lushnje), Beratit, Dumresë (Elbasan), Fushën e Korçës, Fushën e Vrinës (Sarandë), etj. Banorët e pllajës së Dumresë mund të aksesojnë tregun e Lushnjës në 1 orë e 30 minuta nga 3 që duheshin më parë. Njësitë Administrative në zonën e Marinzës janë bërë thuajse një unazë e jashtme e qytetit të Fierit. Prodhimet e fermerëve të fshatrave Kutalli, Kallmet, Fushkuqë, Xarrë e në fushën e Korçës, që dikur nuk arrinin tregun sot janë të lidhura me pikat e grumbullimit dhe aksesohen nga mjetet e transportit të kompanive tregtare. *Lidhja me rrugë e rajoneve të ndryshme të vendit me rrugë rajonale* siç janë Peshkopi - Kukës; Librazhd - Dibër; Berat - Kuçovë; Shkodër - Lezhë; Thumanë - Laç - Milot; etj. Sot banorët e Peshkopisë mund të udhëtojnë për në Kukës dhe anasjelltas për në më pak se 2 orë e 30 minuta.
- *Nxjerrja nga izolimi dhe rritja e aksesit në shërbimet jetësore bazë i popullsisë në zonat e largëta,* siç janë: Drizë -Poroçan, Ura e Matit - Lis, Bilisht - Miras, Gramsh - Kodovjat, Hani i Hotit - Vermosh, etj.

Investimet në infrastrukturën rrugore janë orientuar vazhdimisht drejt nxitjes së zhvillimit ekonomik, nxjerrjes nga izolimi të zonave të largëta, rritjes së aksesit drejt zonave të turizmit dhe rritjes së aksesit drejt shërbimeve bazë. Të kombinuara me ndërtimin e akseve kryesore kombëtare, por edhe programet e tjera të investimit, segmentet e ndërtuara nga Programi kanë çliruar potenciale të zhvillimit, që deri vonë kishin mbetur peng i infrastrukturës së munguar duke sjellë qarkullimin në akset kryesore rurale të vendit drejt tregjeve rajonale, qendrave administrative dhe shërbimeve sociale.

Objektivat studimit i dhe metodologjia

Me qëllim vlerësimin e impaktit të këtij programi Fondi Shqiptar i Zhvillimit ndërmori një studim të thelluar në të cilin u angazhuan profesionistë me eksperiencë ndërkombëtare, nën drejtimin e Dr. Santosh Kumar, Profesor i Asociuar në Ekonomi, pranë Universitetit Sam Houston në Teksas, i cili është edhe autor i këtij studimi. Studimi u shtri në të gjithë vendin dhe mbulon një periudhë 5-vjeçare i (2012-2016).

Ky studim vlerëson ndikimin që kanë pasur rrugët dytësore dhe lokale në përmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve lokale dhe zhvillimin social - ekonomik në nivel lokal dhe rajonal. Krahas informacionit për donatorët, menaxherët, grupet e interes dhe publikun e gjerë mbi efektivitetin e investimeve dhe përfitimet që kanë sjellë për komunitetet, studimi identifikon edhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i këtyre investimeve dhe përmirësimet që në të ardhmen mund të bëhen për projektet e ngjashme që në fazën e konceptimit deri në përfundim të zbatimit.

Analiza bazohet në studimin e ekonomive familjare (household) të administruara në një kampion prej rreth 2,000 familjeve që jetojnë në 144 fshatra në 12 qarqe dhe konsultim me 10 fokus grupe në të dy fazat e studimit 2012 dhe 2016.

Qasja metodologjike e njohur si *difference-in-difference (DID)* ofron një panoramë realiste të përfitimeve. Dy grupe komunitetesh janë marrë në analizë: grupi i komuniteteve përfituese nga

projekti dhe grupi i komuniteteve jo përfituese të cilët janë krahasuar dhe analizuar përpara dhe pas investimeve të kryera në kuadër të PRDL.

Gjetjet kryesore të studimit

Cilësi më e mirë e rrugëve: Ndikimet e menjëhershme të PRDL në cilësinë e rrugës janë të dukshme. Krahasuar me komunitetet jo përfituese, pjesa më e madhe e të anketuarve në komunitetet përfituese e vlerësoi cilësinë e rrugës si "të mirë" ose "shumë të mirë". Distanca me rrugën më të afërt nacionale u ul me 2.1 km dhe koha e udhëtimit për në rrugën më të afërt nacionale rezultoi 71% më e ulët në zonat përfituese se në zonat jo përfituese.

Përmirësim i qasjes në infrastrukturën sociale: Statistikat tregojnë përmirësim të ndjeshëm të aksesit të komuniteteve përfituese në infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore. Koha mesatare e udhëtimit për në qendrat shëndetësore publike (niveli bazik i sistemit të kujdesit shëndetësor) ishte e ngjashme midis komuniteteve, por vihet re një përmirësim i dukshëm i aksesit në qendrat spitalore që cilat janë më larg fshatrave.

Koha e udhëtimit në spital ishte reduktuar me 27% në komunitetet e përfituese. Banorët e komuniteteve përfituese kanë 12% përqind më shumë mundësi të vizitojnë qendrat shëndetësore në rast të nevojave të vogla mjekësore në krahasim me komunitetet jo përfituese. Për më tepër, koha e udhëtimit dhe shpenzimet e udhëtimit në shkollat e mesme u zvogëluan me 31% dhe 54% respektivisht, si rezultat i përmirësimit të kushteve të rrugës. Studimi nuk ka gjetur ndikime statistikisht të rëndësishme për aksesin në shkollat fillore. Ndërsa përsa i përket niveleve më të larta të edukimit, vihet re një rritje e mundësive për përdorimin e transportit publik nga banorët e komuniteteve përfituese për të arritur më shpejt qendrën arsimore përkatëse.

Vlerë më e lartë e tokës në komunitetet e trajtuara: Studimi vlerëson një ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në vlerat e tokës truall dhe bujqësore. Vlera e banesave është 71,000 Lekë më e lartë në komunitetet e trajtuara krahasuar me komunitetet e kontrollit. Vlera mesatare e banesave është rritur me 48%, ndërsa çmimi i tokës bujqësore është 1.2 herë më i lartë në komunitetet përfituese në krahasim me komunitetet jo përfituese.

Rritje e prodhimit bujqësor: Ndikime pozitive të programit u konstatuan në lehtësimin e aksesit të tregut të produkteve bujqësore, kostot e inputeve bujqësore dhe prodhimin bujqësor. 26,1% e komuniteteve përfituese raportojnë se arrijnë tregjet për shitje, ndërkohë që tregjet ishin të arritshme për 17,6 % të fermerëve nga komunitetet jo përfituese. Kështu, fermerët e komuniteteve përfituese kanë një probabilitet më të lartë prej 8,5 pikësh për të shitur produktet e tyre dhe për të pasur më shumë të ardhura. Ndërkaq, kostoja mesatare e inputeve bujqësore është 15.55% më e ulët në komunitetet e përfituese sesa komunitetet e jo përfituese. Prodhimi dhe diversifikimi i kulturave bujqësore është gjithashtu më i lartë 34,2% më i lartë në komunitetet e përfituese krahasuar me komunitetet jo përfituese.

Ndikime pozitive në mundësitë e punësimit: Analiza e të dhënave statistikore dhe intervistave të zhvilluara në terren, vë në dukje se investimet në kuadër të PRDL kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e perspektivave të punësimit të kryefamiljarit. Shkalla e papunësisë e kryefamiljarëve është 12.6 përqind më e ulët dhe vetëpunësimi është rritur me 12.9 përqind në komunitetet përfituese.

Ndikimet në të ardhurat familjare: I njëjti ndryshim pozitiv vërehet edhe në të ardhurat familjare. Familjet në zonat përfituese kanë të ardhura mujore 32,000 lekë më të larta në krahasim me të ardhurat mujore në komunitetet jo përfituese

Rritja e shpenzimeve të konsumit: në shkallë më të gjerë, vërehet se investimet kanë pasur ndikim pozitiv edhe në ekonominë lokale. Tregues për këtë është rritja e shpenzimeve të konsumit të familjeve. Rezulton se pas investimit, në komunitetet përfituese shpenzimet totale familjare (ushqimi dhe shpenzimet jo ushqimore) janë 25% më të larta. Një fakt interesant i zbuluar nga analiza është se ndërsa, zëri i shpenzimeve ushqimore në komunitetet përfituese nuk ka pasur ndryshime, shpenzimet jo ushqimore (veshje, pajisje, aktivitete) janë rritur me 58%. Ky fakt flet për një rritje të cilësisë së jetesës në komunitetet përfituese.

Migrimi dhe kapitali social: Studimi gjeti se investimet e PRDL kontribuan në uljen e lehtë të migrimit nga zonat rurale. Familjet përfituese kishin 2.7 përqind më pak probabilitet për migrim. Nga ana tjetër, investimet kanë sjellë një ndikim pozitiv në sjelljen e komunitetit dhe solidaritetin mes banorëve në zonat përfituese.